

HIDRO IZOLUESIT



DEKOLASTIC

	Ngjyra	Paketimi
A	Gri	Thes 24 KG
B	E bardhë	Bidon 8 KG

PËRSHKRIM

Material hidroizolues dykomponent me fleksibilitet të lartë me bazë çimento, inertesh të seleksionuar me rërë të imët me aditiv specifik dhe polimer fleksibël. Ka punueshmëri të mirë dhe falë rezinave organike përbërëse ka aftësi shumë të mira në ngjitje mbi të gjitha tipet e bazamenteve në betone dhe mure, duke krijuar një shtresë fleksibël dhe të pa përshkueshme. Për ambiente të jashtme dhe të brëndshme.

FUSHA E APLIKIMIT

Hidroizolues për banjo, duše, ballkone, bodrume. Hidroizolues përpara vendosjes së pllakave qeramike, për suva, dysheme, sipërfaqe betoni, i përshtatshëm për riparime mbi parafabrikate.

PËRGATITJA E SUPORTIT

Suportet me bazë çimento duhet të jenë të qëndrueshëm, rezistent dhe të rregullt, pa vajra, jo të pisto dhe pa mbetje bojrash si dhe duhet të kenë arritur paraprakisht kohën e maturimit. Përafërsisht dyshemetë tradicionale me bazë çimento me kohë fortësimi normale duhet të kenë një kohë stazhionimi të paktën 28 ditë, bazamentet me suva tradicionale duhet të thahen për të paktën 14 ditë. Disnivelet e mëdha ose çarjet e mëdha duhet të rregullohen paraprakisht. Të gjitha tipet e suporteve duhet të pastrohen paraprakisht para aplikimit të produktit në mënyrë mekanike. Të vendoset në të gjitha këndet midis murit dhe dyshemesë, nyjeve teknike dhe atyre të kullimit shiriti hidroizolues prej 10 cm.

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Hidhni komponentin B të lëngshëm (8KG) në një enë të pastër dhe duke e përzier hidhni komponentin A të thatë (24KG). Përzieri me një përzierës mekanik derisa të arrihet një masë homogjene, pa kokrriza dhe pa fluska ajri. Koha e punueshmërisë së përzieriës 30 min .




APLIKIMI

Aplikoni produktin në dy shtresa me fuqë ose shpatull, duke e aplikuar rreth 2mm për çdo dorë. Dora e dytë aplikohet pas një periudhe prej 4-6 orë nga njëra-tjetra dhe jo para tharjes së dorës së parë. Produkti përdoret vetëm duke kombinuar komponentin A me komponentin B dhe në sasinë e rekomanduar. Aplikoni produktin në temperatura nga +5°C deri +35°C.



TË DHËNAT TEKNIKE

Komponenti A	
Pamja: Pluhur	Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri
Paketimi: Thes letre 24 kg ne paleta 1350 kg.	Koha e Magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit
Ngjyra: Gri	pH i përzierjes: >12
Konsumi: 1.65 kg/mm trashësi	Masa Vëllimore: 1.6-1.7 gr/cm ³
Komponenti B	
Pamja: Lëng	Magazinimi: 24 muaj
Paketimi: Bidon 8 Kg	Masa Vëllimore: 1.1 gr/cm ³
Ngjyra: E bardhë	



Kujdes! Mos përzieni asnjë produkt tjetër me DEKOLASTIK dhe për të aplikuar dorën e dytë duhet të siguroheni që dora e parë të jetë plotësisht e thatë. Bidonat bosh nuk duhet të përdoren për ujë të pijshëm. Mos aplikoni mbi hidroizolues bituminoze. Shmangni aplikimin në ditë të nxehta ose me shumë erë, mbi bazamnete me ngrica dhe në fazë shkrirje. Sigurohuni që bazamenti të jetë plotësisht i thatë për të realizuar veshje me pllaka apo lyerje me bojë elastike .